



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS

NOTER EMIL P. BARÇI
ADRESA KONGRESI I ELBASANIT,
28 NENTORI, NR.36, KATI I PARE
TEL: 692087200



KONTRATË SHITJE PASURIE LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 362

Nr. koleksioni: 175

Elbasan më 22/05/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2020010830010552419



TRAKSA E PULLES
1 LIKUJDDUA

A2020010830010552419



KONTRATË SHITJE

(kuotash kapitali themeltar ne SH.P.K.)

Sot, më datë **22.05.2020**, para meje noterit Emil P. Barçi, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Durrës, me zyrë në adresën qyteti Elbasan, lagjja "Kongresi i Elbasanit", rruga "28 Nentori", pall. 36, kt.1, u paraqiten personalisht palet kontraktuese :

- Në cilësinë e shitësit : **GENTIAN PRIFTI**, atësia Kristaq, i dtl. 21.07.1972, lindur dhe banues në Elbasan, pajisur me letërnjoftim nr. 034306854, me NID - **H20721061B**, me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Sipas çertifikatës familjare vulosur elektronikisht në datë 22.05.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, shitësi Gentian Prifti rezulton me gjendje civile "i martuar".
- Jep pëlqimin për lidhjen e kësaj kontrate, bashkëshortja e shitësit, zj. **Darina Prifti**, atësia Halit, e dtl. 28.10.1970, lindur në Elbasan, pajisur me pasaportë nr. BD7963735, me NID - **H06028086R**, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Në cilësinë e blerësit : **ALMA KABASHI**, atësia Mislim, e dtl. 03.03.1971, lindur në Gramsh, banuese në Elbasan, pajisur me letërnjoftim nr. 030622444, me NID - **H15303070W**, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Sipas çertifikatës familjare vulosur elektronikisht në datë 22.05.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, blerësja Alma Kabashi rezulton me gjendje civile "e martuar" me z. **Arben Sharra**, atësia Mustafa, i dtl. 19.07.1969, lindur dhe banues në Elbasan, me NID - **G907191220**.

Personat e lartpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar, bazuar ne nenin 761 e vijues të Kodit Civil, nenin 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nenin 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate shitje per kuota kapitali te SH.P.K. sipas kushteve të mëposhtme :

- Objekt i kësaj kontrate është shitja tërësisht e kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë "B&B Fashion" sh.p.k. nga ortakut i vetëm Gentian Prifti, në favor të blerëses Alma Kabashi.
- Shoqëri tregtare "B&B Fashion" sh.p.k. është regjistruar në Q.K.B. në datë 23.09.2013, pajisur me NIPT – L33323201D, me seli në Ish-Nish Vaji, Elbasan, me ortak të vetëm z. Gentian Prifti, që zotëron 100 % të kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë. Sipas ekstraktit të Q.K.B.-së, marrë elektronikisht në datë 22.05.2020, shoqëria rezulton me status "aktiv".
- Me vendim nr. 2, datë 22.05.2020, të Ortakut të vetëm të shoqërisë tregtare, është vendosur shitja tërësisht e kuotës së kapitalit themeltar, në favor blerëses Alma Kabashi.
- Sipas konfirmimit të marrë elektronikisht në datë 22.05.2020, nga Regjistri i Barrëve Siguruese, nuk ka të regjistruar asnjë akt ligjor në ngarkim të shoqërisë "B&B Fashion" sh.p.k. dhe të ortakut të vetëm Gentian Kristaq Prifti.
- Palët kontraktuese deklarojnë se kanë caktuar si çmim shitje për **100 %** e kuotës së kapitalit themeltar, vlerën monetare **100.000 Lekë** (njëqindmijë), e cila është transferuar nga blerësi, tek shitësi, tërësisht në Cash, dhe jashtë kësaj zyre noteriale.



Shitësi deklaron se garanton se deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, nga ana e tij, janë shlyer të gjitha detyrimet tatimore, lidhur me tatim fitimin, akcizën, tatimin mbi të ardhurat personale, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, e taksat vendore si dhe nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për transferimin e pronësisë së kuotës së kapitalit themeltar të kësaj shoqërie tregtare.

Blerësja deklaron se, merr përsipër çdo detyrim ligjor si dhe shlyerjen e çdo detyrimi financiar, që mund të konstatohet në të ardhmen, edhe për periudhën para nënshkrimit të kësaj kontrate, si dhe për çdo detyrim që rrjedh nga zotërimi i kuotës së kapitalit të shoqërisë, nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate deri në çastin e regjistrimit të saj.

Palet bien dakort që të ardhurat e paarketuara nga shoqëria, si dhe shlyerja e detyrimeve ndaj furnitoreve, të perfitohen dhe njekohesisht të merren përsipër nga Blerësja.

Me nënshkrimi i kësaj kontrate shitje nga palët kontraktuese, kuota e kapitalit themeltar të shoqërisë "B&B Fashion" sh.p.k. do të rezultojë tërësisht në pronësi të zj. Alma Kabashi.

Blerësi, në bazë të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, duhet të kryejë regjistrimin e kontratës pranë Q.K.B.-së.

Kontrata u redaktua në katër kopje të njëjta, dhe pasi u lexua nga unë noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë, në prani të palëve kontraktuese, prej tyre mu deklarua se e kuptuan përmbajtjen e saj, se u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike. Palet kontraktuese e nënshkruan atë me vullnet të lirë e të plotë, përpara meje noterit. Bashkangjitur kontratës është një kopje e vendimit të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

Shitës

GENTIAN PRIFTI

Gentian Prifti

Bashkëshortja e shitësit

DARINA PRIFTI

Darina Prifti

Blerës

ALMA KABASHI

Alma Kabashi

Noter

EMIL P. BARÇI

Emil P. Barçi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L33323201D	
2. Data e Regjistrimit	23/09/2013	
3. Emri i Subjektit	B & B FASHION	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	23/09/2013	
6. Kohëzgjatja	Nga: 23/09/2013	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Elbasan Elbasan ELBASAN Godina 3-kateshe, kati 3, tek Ish Nish Vaji, ura e Zaranikes.	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Importim dhe tregtimin e stofrave dhe lendeve të pare ndihmese, makineri dhe pajisje prodhimi, tregtim me shumice dhe pakice, import eksport të të gjitha llojeve të konfeksioneve dhe veshjeve, sportive dhe kepuce.Import dhe eksport dhe shitje me shumice dhe pakice të artikujve industrial dhe ushqimore dhe cdo mall tjetër të lejuar nga ligji	
10. Administratori/ët	Gentian Prifti	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 23/09/2013	Deri: 21/09/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	GentianPrifti	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	



RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2020052292140384
Data e Rezultatit të Kërkimit: 22.05.2020
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 9:21:40AM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-104-1551
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

GENTIAN KRISTAQ PRIFTI
B & B FASHION SH.P.K.



Arta Lekku